REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT

PROJEKT-VENDIM

Nr.47. Datë 28/07/2025

"PËR DHËNIN NË PËRDORIM TË SIPËRFAQES PREJ 2.968 HA NE FONDIN PYJOR/KULLOSOR ,PËR VENDOSJEN E KULLAVE EOLIKE "

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore"(I ndryshuar),neni 8 , pika 2 , neni 9 , pika 1 , nenpikat 1.1 , shkronja(b) dhe 1.2 shkronjat "a" dhe "c" , nenit 27 dhe pika 5 , nenit 54 shkronja "e/1" nenit 55 pika3, nenit 64 shkronja"a" dhe "c".Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil I Republikës të Shqipërisë" (I ndyshuar) , Ligjit 57/2020 "Për Pyjet " . "VKM nr. 433, datë 8.6.2016, të këshillit të ministrave(I ndyshuar) .Vendim nr. 398 , datë 13.5.2020, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive" ", Vendim Nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore,"(I ndryshuar). VKM Nr. 267, datë 27.4.2023 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022, të këshillit të ministrave, Udhezim Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" dhe në Raportin Tektiko – Ekonomik Nr.Prot 4004/1 datë 07/05/2025

Propozoj:

1- Dhënien e miratimit për dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 29,680 m^2 (**2.968 ha**) .Në ngastrat me Kod Kadastral KO71 00 078 , KO71 00 054, KO71 00 053/a, KO71 00 053/b, KO71 00 049, KO71 00 047, KO71 00 027, KO71 00 026, KO71 00 025, KO71 00 024,Ekonomia Pyjore Zëmblak-Verlen , me qëllim dhënien në përdorim të sipërfaqes prej 2.968 ha ,për vendosjen e kullave eolike . Bashkëngjitur Raporti Tekniko – Ekonomik Nr.Prot 4004/1 datë 07/05/2025 , i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Mjedisit.

2- Akti i dhënies në përdorim do të jetë 10 vjet nga nenshkrimi i kontratës të qirasë .

3- Ky Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve në nenin 55 pika 6 të Ligjit .139/2015"Për vetëqeverisjen vendore" I ndyshuar .

Konceptoi: Drejtori I Drejtorisë të pyjeve dhe mjedist

Edmir Cenolli

Konfirmoi: Pergj.Sek Juridik

Eriksela Avdo

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA DEVOLL

Adresa: Lagjia. Nr 1 Rr. 24 Tetori Nr. 5, Tel&Fax +35581122288 E-mail bashkiadevoll@gov.al
web:http://bashkiadevoll.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TE PYJEVE DHE MJEDISIT

Nr. 1404 **Prot** **Bilisht më,** 22/05/**2025**

RAPORT TEKNIK – EKONOMIK

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË PRONËSI PUBLIKE TË BASHKISË DEVOLL

(Për dhënin në përdorim të sipërfaqes prej **2.968 ha** ne fondin pyjor/kullosor ,për instalimin e bazamenteve të kullave eolike ,Subjekti WP Morava sh.p.k)

Bazuar në Urdhërin Nr.335, datë 22.04.2025 të Kryetarit të Bashkisë ,me Nr.Prot. 1404 datë 22.04.2025 , për pregatitjen e raportit tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore objekt i dhënies në përdorim. Grupi i punës i përbërë nga specialist/Ing i Pyjeve dhe Kullotave dhe Mjedisit : Ing.Orgest Cenolli , Antonio Kapshtica dhe Armaldi Doko nga data 23/04/2025 deri në datën 28.04.2025 ,_realizuan verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore_ objekt i dhënies në përdorim. Projekti shtrihet midis tre Bashkive,atë të: Devollit ,Maliqit dhe Korçës me siperfaqe totale të kërkuar prej **48,673m2** dhe gjithsej 13 Turbina ..
Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor / kullosor te Bashkisë Devoll , rezulton që sipërfaqja e kërkuar nga subjekti , në fondin Pyjore të Bashkisë Devoll , është **29,680 m2** ose **2.968 ha** ,dhe do të pozicionohen 9 turbina.
Vendndodhja e Turbinave do te jete si më poshtë :

Turbina 4 : Ngastra Pyjore 078, Ek.Pyjore Zemblak-Verlen **-0.2387 ha**
Turbina 5:Ngastra Pyjore 054 , Ek.Pyjore Zemblak-Verlen **-0.0545 ha**
Turbina 6:Ngastra Pyjore 054, Ek.Pyjore Zemblak-Verlen **-0.196 ha**
Turbina 7:Ngastra Pyjore 053/a/b , Ek.Pyjore Zemblak-Verlen **-0.571 ha**
Turbina 8,Ngatra Pyjore 049 , Ek.Pyjore Zemblak-Verlen **-0.173 ha**
Turbina 9,Ngastra Pyjore 047,Ek.Pyjore Zemblak-Verlen **-0.3045 ha**
Turbina 10 ,Ngastra Pyjore 027 dhe 026 Ek.Pyjore Zemblak-Verlen **- 0.2014 ha**
Turbina 11 , Ngastra Pyjore 0.25 Ek.Pyjore Zemblak-Verlen **-0.3524 ha**
Turbina 12 , Ngastra Pyjore 0.24 ,Ek.Pyjore .Zemblak-Verlen **-0.8356 ha**

Përshkrimi parcelar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj, pasqyrohet në aneksin 1 të këtij raporti .
Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqëria WP Morava sh.p.k nuk ndyshojnë kategorinë e përdorimit por jepen në përdorim më afat 10 vjecar ,

Proçedura që ndiqen për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik janë të mbështetura në Ligjin 57/2020 "Për Pyjet " , Udhëzimin e Ministrisë të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat , proçedurat e kërkimit , të shqyrtimit e të miratimit për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik." . Vendim nr. 398 , datë 13.5.2020 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të këshillit të ministrave, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive" Vendim Nr . 559 , date 29.07.2022 " Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar , për veprimtari ekonomike , si dhe për prodhime drusore dhe jodrusore pyjore"

Shtojca Nr 1 "Për tarifat e dhenies ne përdorim e fondit pyjor kombetar për veprimtarite e ushtruara ne kete fond" *Lidhja Nr 8 .(Vlera e përdorimit të kullotës dhe cungishtes është 176,000 lek/ha vit)*

Shtojca Nr.3 "Tarifat për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ,për grumbullimin dhe nxjerjen e prodhimeve te dyta Pyjoore dhe JoPyjore"

Lidhja 3/1(Dru zjarri në këmbë : *600 lek/m^3*)

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër , shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur , vetëm pas lidhjes së kontratës me **Bashkinë Devoll** dhe likujdimin të tarifës prej **541,368 vlekë/vit. (TOTAL)**

a) Vlerën e përdorimit e sipërfaqes lek/ha/vit 522,368 lekë

Trungishte	_____ha	x_____ _	lek =	_____	lekë.
Cungishte	**2.968 ha**	**x 176,000**	**lek =**	**522,368**	**lekë.**
Shkure	ha	x _____	lek =	_____	lekë.
Kullotë	ha	x	lek =		lekë
Inproduktive etj	__ha	x_____	lek =	_____	lekë.

b) Vlera e përdorimit/ndertimit për linjat gjatësore në km/vit lekë

Trungishte	km x	lekë =	lekë.
Cungishte	km x	lekë =	lekë.
Shkure	km x	lekë =	lekë
Kullotë	km x	lekë =	lekë
Inproduktive etj	km x	lekë =	lekë.

c) Tarifa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar në fondin pyjor/kullosor 19,000 lek
.(Shenim: Vetem për vitin e pare kryhet pagesa)

1. Vlera e lëndës së punimit _____-_____ lekë.
2. Vlera e druve të zjarrit 25 m^3 * 600 lek/m3 = 15,000 lekë.
3. Vlera e prodhimeve të dyta pyjore 2500 lekë.
4. Kullotja lekë.
5. Vlera e faunës 1500____lekë.
6. Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zvëndësime, përmirësime, etj _-_ lekë.

PËRPILUSIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Specialist/ING i Pyjeve,Kullotave dhe Mjedisit

Orgest Cenolli

Antonio Kapshtica

Armaldi Doko

Drejtori I Drejtorisë
Edmir Cenolli

KRYETARI I BASHKISË
EDUARD DURO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DEVOLL

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E PYJEVE DHE MJEDISIT
SEKTORI I MENAXHIMIT TE PYJEVE,KULLOTAVE DHE MJEDISIT

Nr. 1533 prot. Bilisht, më 07.05.2025

RELACION

PËR

PROJEKT VENDIMIN

"PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË SIPËRFQAQES PREJ 2.968 HA , FOND PYJOR/KULLOSOR PËR VENDOSJEN E AEROGJENERATORËVE "

Të Nderuar Këshilltarë të Bashkisë Devoll !

Nisur nga kerkesa e subjektit WP MORAVA SH.P.K , për marjen në përdorim të kësaj sipërfaqeje pyjore/kullosore për instalimin e kullave eolike , u ngrit urdhëri i Kryetarit të Bashkisë me numër 355 datë 22.04.2025 , me Nr.Prot.1404 , date 22.04.2025 , për përgatitjen e Raportit Teknik-Ekonomik , Pjesë të Ekonomisë Pyjore "**Zëmblak – Verlen**" , dhe pas studimit te këtyre ngastrave pyjore/kullosore për efektet që mund të vijnë nga instalimi i **9 (nëntë)** kullave eolike , u përgatit Raporti Teknik-Ekonomik .

Baza ligjore ku jemi referuar për dhenien me qira të kësaj sipërfaqeje është : Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore". Neni 12 "*të drejtat dhe detyrimet mbi pyjet* " , Neni 25 "*Përfitimet nga shfrytëzimi për veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar*," pika 3 , e Ligjit 57/2020 "Për Pyjet". VKM Nr. 559,datë 29.07.2022 për "Përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore". Udhezim Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik"

1. Hyrje

Vendosja e kullave eolike në kurrizin e Malit të Moravës është një projekt i rëndësishëm që synon të shfrytëzojë energjinë e rinovueshme nga era për të prodhuar energji elektrike. Ky projekt është një mundësi për të kontribuar në zhvillimin e energjisë së pastër dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të zones .

2.Karakteristikat e Malit të Moravës

Mali i Moravës është një masiv malor që ndodhet në pjesen perendimore te rrethit te Devollit dhe përfshin një sipërfaqe të gjerë. Ky mal ka disa karakteristika që e bëjnë atë të përshtatshëm për instalimin e kullave eolike:

- **Shpejtësia e erës**: Kurrizi i Malit të Moravës ka kushte të mira për prodhimin e energjisë eolike, pasi ajri është i pasur me erëra të qëndrueshme dhe me shpejtësi të lartë.
- **Lartësia:** Lartësia e malit ofron mundësinë për të instaluar aerogeneratorët në një nivel më të lartë, ku mund të kapet më shumë energji nga era.

3. Avantazhet e Vendosjes së Kullave Eolike

- **Energjia e rinovueshme**: Kullat eolike do të sigurojnë energji të pastër , te cilat nuk kane impakte negative ne mjedis , nuk emetojne gaze sere dhe do jene nje kontribut i madh në luftën kundër ndryshimeve klimaterike.
- **Krijimi i vendeve të punës**: Ky projekt do të sjellë mundësi të reja punësimi për banorët e zonës, duke ofruar mundësi në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe operimin e kullave.
- **Zhvillimi i zones**: Vendosja e kullave eolike do të kontribuonte në zhvillimin ekonomik të rajonit, duke sjellë investime dhe mundësi për zhvillimin e industrive të tjera përreth.
- **Përshtatshmëria e terrenit**: Mali i Moravës ka një strukturë gjeologjike të fortë dhe të qëndrueshme, e cila është e përshtatshme për mbajtjen e kullave të larta të energjisë eolike.

4.Disavantazhet e Mundshme të Projektit

Megjithëse projekti ka shumë përfitime, duhet të merren parasysh disa disavantazhe që mund të shoqërojnë instalimin e kullave eolike:

- • **Ndikimi vizual dhe estetika**: Kullat eolike, veçanërisht kur janë të larta, mund të ndryshojnë pamjen natyrore të peizazhit dhe të ndikojnë në atraksionin turistik të zonës. Disa banorë dhe vizitorë mund të shqetësohen për ndikimin vizual të këtyre objekteve.
- • **Zhurma**: Turbinat e erës krijojnë një nivel zhurme gjatë funksionimit të tyre, që mund të ndikojë në cilësinë e jetesës për banorët që jetojnë pranë zonës ku do të instalohen kullat. Ky shqetësim mund të jetë më i theksuar në periudhat e mëngjesit dhe mbrëmjes.
- **Ndikimi në pyjet bashkiake:** Në disa zona ku do të vendosen turbinat, ka pemë të llojeve të ndryshme, si **Ah (Fagus Sylvaticca)** dhe individë **Pishe te zeze (Pinus Nigra)** , të cilat janë të vlerësuara si materiale drusore nga ana e sektorit të menaxhimit të Pyjeve. Këto pemë do të preken nga ndërtimi i infrastrukturës dhe vendosja e kullave. Si pasojë, do të duhet të hiqen disa individë të këtyre pemëve, dhe vlerësimi i materialit drusor do të bëhet nga Drejtoria e Pyjeve. Vëllimi i drurit që do të hiqet do të vlerësohet në vlerë monetare dhe subjekti do të paguajë këtë shumën vetëm vitin e parë, si pjesë e detyrimeve të tij për dëmet mjedisore të shkaktuara nga ky projekt.

4. Studimet e Detajuara të Burimeve të Erës

Para vendosjes së kullave, subjekti **Alb Power SH.P.K**, ortake e shoqërisë **WP Morava SH.P.K**, ka realizuar studime të detajuara për burimet e erës në rajonin e Malit të Moravës, pasi ka një kontratë qeraje me Bashkinë Devoll , me kontraten me Nr.Prot.3469 , date 18.10 ,2022 "Për instalimin e shtylles matese anemometer per identifikimin e intesitetit te eres". Ky studim përfshin matjen e shpejtësisë dhe rrymave ajrore, duke përdorur një pajisje anemometër. Të dhënat e mbledhura nga ky studim janë thelbësore për të përcaktuar mundësitë e prodhimit të energjisë eolike dhe për të vlerësuar qëndrueshmërinë e projektit.

5. Përzgjedhja e Vendndodhjes së Kullave Eolike

Vendndodhja për vendosjen e kullave eolike është përcaktuar pas analizës së të dhënave të mbledhura nga studimet e erës. Nepermjet kerkeses me Nr.Prot 1 date 14.04.2025 , bashkeshoqeruar me Plan Vendosjen ne formatin A3 , subjekti ka shprehur se ,kurrizi i Malit të Moravës është identifikuar si zona më e përshtatshme për instalimin e kullave, duke marrë parasysh shpejtësinë e erës, lartësinë dhe karakteristikat gjeografike .

Konceptoi:
PRGJ.Sektori Menaxhimi
Orgest Cenolli

Pranoi:
Drejtori i Pyjeve dhe Mjedisit
Edmir Cenolli